



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore

Data	
Nr. Prot	

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

PËR

MIRATIMIN E FORMATIT DHE SPECIFIKIMEVE TË VULËS SË KOMISIONIT TË ZONËS SË
ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR, TË VULËS SË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT, VULËS SË
KRYETARIT TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT DHE TË VULËS REZERVË TË KOMISIONIT
TË QENDRËS SË VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14
MAJ 2023

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË FUQI

Neni 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 28.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të ushtruar në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar përcaktimeve të nenit 99, të Kodit Zgjedhor, KQZ dërgon në Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), materialet zgjedhore që përdoren nga KZAZ për administrimin e procesit zgjedhor, dhe materialet zgjedhore për Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV), për administrimin e procesit të votimit në qendrën e votimit. Në materialet zgjedhore të përcaktuara në këtë dispozitë, përfshihen vula e KZAZ-së, vula e KQV-së, vula e Kryetarit të KQV-së, vula rezervë për KQV-të.

Kodi Zgjedhor, në nenin 103, pika 2, përcakton tekstin që duhet të përmbajë:

vula e KQV-së: “KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT” dhe numrin e qendrës përkatëse të votimit;

vula e kryetarit të KQV-së: “KRYETARI” dhe një numër serial pesëshifror;

vula rezervë: teksti është unik për secilën vulë, përcaktuar me vendimin e Komisionit Rregullator nr. 11, datë 28.12.2020 “Për caktimin e rregullave të administrimit dhe shpërndarjes së vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit”.

Në zbatim të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenit 99, pikat 1, shkronja “b”, dhe 2, nenit 103, pikat 1 dhe 2, të Kodit Zgjedhor, është hartuar projektvendimi “Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës së Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, të vulës së Komisionit të Qendrës së Votimit, vulës së kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe të vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Formati dhe specifikimet e vulës së KZAZ-së, vulës së KQV-së, vulës së Kryetarit të KQV-së, dhe vulat rezervë për Komisionet e Qendrave të Votimit, referojnë përcaktimet e VKM nr. 390, datë 6.08.1993 “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit, dhe ruajtjen e vulave zyrtare”, të ndryshuar. Ato prodhohen në sektorin e prodhimit të vulave zyrtare, pranë Ministrisë së Brendshme, me kosto 1800 (njëmijëetëqind) lekë.

Ky projektvendim nuk paraqet kosto shtesë për Buxhetin e Shtetit, dhe shpenzimet do të përballohen nga buxheti i miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara Kodi Zgjedhor, i propozohet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, të vulës së Komisionit të Qendrës së Votimit, vulës së Kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit, dhe të vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Bashkëlidhur projektvendimit paraqiten:

- lidhja 1, formati dhe specifikimet e vulës së KZAZ-së;
- lidhja 2, formati dhe specifikimet e vulës së KQV-së;

- lidhja 3, formati dhe specifikimet e vulës së KQV-së;
- lidhja 4, formati dhe specifikimet e vulës rezervë të KQV-së

Erion META – Drejtoria e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore

Madalena KOJA – Drejtoria Juridike dhe e Dokumentacionit Zgjedhor

Ylli MERKAJ – Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

MIRATIMIN E FORMATIT DHE SPECIFIKIMEVE TË VULËS SË KOMISIONIT TË ZONËS SË
ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR, VULËS SË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT, VULËS SË
KRYETARIT TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT DHE VULËS REZERVË TË KOMISIONIT TË
QENDRËS SË VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14
MAJ 2023

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 99, pikat 1, shkronja “b”, dhe 2, nenit 103, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I:

1. Miratimin e formateve dhe specifikimeve të vulave që do të përdorë administrata zgjedhore për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, si më poshtë:
 - a) vula e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi,
 - b) vula e Komisionit të Qendrës së Votimit, sipas lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi,
 - c) vula e Kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit, sipas lidhjes nr. 3 që i bashkëlidhet këtij vendimi,

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456
Ora: hh:mm



“Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës së KZAZ-së, KQV-së, Kryetarit të KQV-së dhe vulës rezervë për KQV- në për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

- ç) vula rezervë për Komisionit të Qendrës së Votimit, sipas lidhjes nr. ,4 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

Formati i vulës: KZAZ



Legjenda:

1. Diametri = 38 mm
2. Stema e Republikës së Shqipërisë
3. tekst: Republika e Shqipërisë
4. tekst: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
5. Numri i Identifikimit: KZAZ-NR-XX.
6. tekst: Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023
Formati i vulës: KQV



Legjenda:

1. Diametri = 38 mm
2. Stema e Republikës së Shqipërisë
3. tekst: Republika e Shqipërisë
4. tekst: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
5. Komisioni i Qendrës së Votimit
6. Numri i identifikimit: numri i qendrës përkatëse të votimit
7. tekst: Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

Formati i vulës: Kryetari i KQV-së



Legjenda:

1. Gjatësia = 50 mm
2. Gjerësia = 25 mm
3. Stema e Republikës së Shqipërisë
4. tekst: Republika e Shqipërisë
5. tekst: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
6. KRYETARI
7. Numër serial pesëshifror: XXXXX
8. tekst: Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

Formati i vulës: KQV - REZERVË



Legjenda:

1. Diametri = 38 mm
2. Stema e Republikës së Shqipërisë
3. tekst: Republika e Shqipërisë
4. tekst: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
5. Komisioni i Qendrës së Votimit
6. Numri i identifikimit: numri i qendrës përkatëse të votimit; tekst: REZERVË
7. tekst: Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023